



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0371

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi- Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE PRO MEDICAL SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “SERVISIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE” me numër të prokurimit 623-24-1132-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, më 10/07/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “Pro Medical Sh.P.K.” me nr. 2024/371 , e datës 10/05/2024 lidhur me aktivitetin e “Servisimi i Pajisjeve Mjekësore” me nr. të prokurimit: “623-24-1132-2-2-1” inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal – Rahovec.

2.Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Kuvendi Komunal – Rahovec në lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankes bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.02.2024 Kuvendi Komunal – Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Servisimi i Pajisjeve Mjekësore” me nr. të prokurimit: “623-24-1132-2-2-1”. Ndërsa me datë 29.05.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku është anuluar aktiviteti i prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 30,000.00 €.

Me 21.04.2024 OE “Pro Medical Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.04.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 26.04.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Pro Medical Sh.P.K.” me nr. 371/2024 lidhur me aktivitetin “Servisimi i Pajisjeve Mjekësore” me nr. të prokurimit: “623-24-1132-2-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Pro Medical Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “AK-së është detyruar të respektojë DT për Kërkesën 2, ashtu siç është kërkuar DT, në vend që të na përjashtojë pa asnjë bazë ligjore nga ky aktivitet i prokurimit. Certifikatat e dorëzuara plotësojnë kërkesat specifike të DT, sepse Certifikate e Adnan Bala nga BIOELAB i cilin është çerfikuar për gjitha pajisjet e laboratorit pra Vitro Diagnostic devices (IVD) ose shqip Diagnostika in vitro (IVD) ku përfshihet edhe Aparati hematologjik sepse IVD janë pajisje mjekësore dhe aksesore të përdorura për të kryer teste mbi mostra, siç është gjaku apo indi, të marrë nga trupi i njeriut, pra ne grupin IVD bëjnë pjese pra një game më të gjerë pajisjesh të laboratorit ose grupeve të pajisjeve të Diagnostifikimit In Vitro (IVD) si: Analizatori Kimik Automatik, Analizator Kimik Semi-Automatik, Analizatori i Koagulacionit Semi-Automatik, Analizatori i Hematologjisë Automatik kurse AK ka kërkuar për Analizator i Hematologjisë qe kjo certifikate e mbulon këtë fushe dhe tejkalon kërkesat min te AK te cekur ne DT. Aparati Hematologjik i përkasin kategorisë brenda sferës së pajisjeve për diagnostikimin in vitro (IVD), por nese AK nuk ka pasur njohuri për këtë ka mundur të kërkoj informacion shtes nga ne lidhur me kete e jo të na eliminoj me arsyetim e cekur ne LS, ju lutem shikon certifikate më poshtë.Pra termi i cekur ne certifikatën është cekur IVD - In vitro diagnostic medical devices (IVDs) në shqip d.m.th Pajisjet mjekësore diagnostike in vitro (IVDs) janë teste të përdorura në mostra biologjike për të përcaktuar gjendjen e shëndetit të një personi ose shiko me poshtë termi apo kuptimi i IVD, ju lutem shiko përshkrimi nga Komisioni European. Në ankese është i bashkangjitur linku. Certifikata për këtë aparaturë hematologjike dhe biokimike dhe pajisjet tjera të laboratorit janë grupuar dhe kategorizuar në terminologjinë e in vitro diagnostic medical device (IVD). Kjo certifikatë mbulon këtë fushë dhe pajisjet përkatëse, duke plotësuar kërkesat minimale të përcaktuara në specifikacionet e tenderit për DT. “

Pretendimi i dytë (II) : “Kurse sa i përket arsytimit te AK për eliminimin tonë duke kërkuar autorizimin nga noter.Ne kemi thënë sqarim për AK shtesë përmes Letrës Standarde për të sqaruar tenderin më datën 17.04.2024. Megjithatë, AK nuk e ka marrë parasysh sqarimin tonë, ju

lutem shikoni sqarimet qe kemi dorëzuar tek AK me datën 17.04.2024 tek Dokumentet - Letrat standarde ne e-prokurim ose dëshminë e bashkangjiture kësaj Ankese. Në lidhje me arsyetimin e AK të cekur më lart për kontratën, AK duhet të ketë parasysh se Deklarata nën betim është nënshkruar nga personi përgjegjës. Për çështjet e autorizimit, KRPP bën të qartë se procedurat për të autorizuar një person për të nënshkruar Deklaratën nën Betim ose dokumente të tjera nuk rregullohen nga LPP, dhe as nga legjislacioni i detyësorëve të nxjerrë nga KRPP shiko OPINIONE me nr.14 e datës 24.10.2023 sqarimin / opinionin e KRPP. Po ashtu, është e rëndësishme të theksojmë se Nexhmije Bala ka autorizim të brendshëm nga kompania për nënshkrimin e kontratave, duke përfshirë rastet e mundshme të konfliktit të interesit, sipas rregullores së brendshme të kompanisë. Nuk është obligative që autorizimi i brendshëm për nënshkrimin e kontratës në emër të Pro Medical të noterizohet, siç pretendohet nga AK, pasi asnjë ligj nuk kërkon që autorizimet e brendshme të kompanisë të noterizohen, duke përfshirë Ligjin e Prokurimeve Publike, ne kemi konsultuar noterin në lidhje me të. Noteri konstatoi se autorizimet e brendshme nuk janë të përcaktuara ligjërisht të nevojshme për të notorizuar dhe nuk është obligative, pra as ligjet si ATK dhe Ligji i punës nuk e përcakton një kërkesë të tillë dhe as LPP. AK duhet të ketë parasysh nenin 59.4 (ii), i cili përfshin vetëm devijime të vogla që nuk shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Këto devijime duhet të kuantifikohen, sa të jetë e mundur, dhe të merren parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Kjo e bën të qartë se çështja nuk ndikon në aspektin material dhe janë lëshime të vogla që nuk duhet të merren parasysh nga AK-ja. Pra Vendimi i AK bie ndesh me Nenet dhe RrPP te cekur me poshtë dhe pretendimi jonë i cekur me lartë është i bazuar sepse AK nuk ka respektuar LPP dhe RrPP.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “Pro Medical Sh.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 52, 59 LPP-së si dhe neni 40 i RrPP-së. Kërkojmë nga Organi shqyrtues i prokurimit qe te merr Vendim te Aprovohet Ankesa si e bazuar e OE ” Pro Medical” Të Anulohet Vendimi i AK dhe Ri-kethen lenden ne ri-vlerësim.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: “Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ku kemi cekur: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT): Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 2: Dy (2) Serviser me certifikata trajnimi për pajisje biokimike dhe hematologjike; Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 2: Certifikata trajnimi për Serviser të Certifikuar dhe te bashkangjitura me kontrata te punës; Sqarimet janë si në vijim: Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën Serviser me certifikata trajnimi për pajisje biokimike dhe hematologjike, keni prezantuar z. Adnan Bala dhe z. Nazim Lohaj; Certifikata e dorëzuar për z. Adnan Bala, nuk është e drejtimit përkatës sipas Kërkesës në Dosjen e Tenderit: 3 4 Po ashtu Kontrata e dorëzuar për Adnan Bala, në Nenin 1 të kësaj Kontrate Ceket, shih foto: Ndërsa në kundërshtim me Nenin 1 të kësaj Kontrata, Nënshkrimi i Kontratës për Punëdhënësin është bërë nga Nexhmije Bala, shih foto: Ne si AK: Komuna e Rahovecit, ne bazë të formularit: B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, kemi kërkuar këto sqarime, duke cekur: Pra në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, përkatësisht të nenit 72 kërkoj sqarime shtesë si në vijime: Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 2: Dy (2) Serviser me certifikata trajnimi për pajisje biokimike dhe hematologjike; Dëshmia 2: Certifikata trajnimi për Serviser të Certifikuar dhe te bashkangjitura me kontrata te punës; Ne ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën, Serviser të

Certifikuar për Adnan Bala, Kontrata e punës e prezantuar, tek Pjesa për Punëdhënësin, kontrata është e Nënshkruar nga Nexhmije Bala, e cila nuk është bashkëpronarë në Certifikatën e Biznesit, po ashtu nuk ka ndonjë autorizim për nënshkrimin e kontratës; Ne si Autoritet Kontraktues: Komuna e Rahovecit, kërkojmë nga ana juaj të na dorëzoni Autorizim të Kompanisë nga Noteri për Nexhmije Bala, që ka Autorizim për Nënshkrimin e Kontratës, duke u bazuar në nenin 72.5 Ju si Operator Ekonomik, nuk keni arritur të dorëzoni Autorizim të Kompanisë nga Noteri për Nexhmije Bala, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 02/05/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 371/2024, ndërsa me datë 10/05/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/371 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu edhe OE Nuk Pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Pro Medical Sh.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/371 ka vlerësuar si në vijim:\

Sqarim hyrës: “Lidhur me aktivitetin e prokurimit: “SERVISIMI I PAJISJEVE JEKËSORE”, me numër të prokurimit: 623-24-1132-2-2-1, të iniciuar nga AK – KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË. Pretendimet ankimore të OE ankues: “PRO MEDICAL” SH.P.K. - Ferizaj, kanë të bëjnë kundër letrës standarde të datës 19.04.2024, me arsyetimet të eliminimit të ofertës si dhe anulimin e tërësishëm të aktivitetit të prokurimit. Autoriteti kontraktues KK-Rahovec, si arsyetim të eliminimit të OE ankues ku ka përshkruar: “OE nuk ka plotësuar kërkesat minimale, sipas dosjes së tenderit të FTD-se”. III.2.4) Kapaciteti Teknik dhe Profesional: Kërkesa 2 Dy (2) Serviser me certifikata trajnimi për pajisje biokimike dhe hematologjike. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 2 Certifikata trajnimi për Serviser të Certifikuar dhe të bashkangjitura me kontrata të punës. Në ofertën e juaj të dorëzuar për pozitën Serviser me certifikatë të trajnimit për pajisje biokimike dhe hematologjike, keni prezantuar z.Adnan Bala dhe z.Nazim Lohaj. Certifikatat e dorëzuar për z.Adnan Bala nuk është e drejtimit përkatës sipas kriterit të dosjes së tenderit. OE nuk ka prezantuar autorizim të noterizuar për znj. Nexhmije Bala, andaj oferta juaja

është e pa përgjegjshme për kundër faktit se për gjate vlerësimin të ofertave, Autoriteti Kontraktues, bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-se, ka kërkuar që të dorëzohet autorizim i noterizuar.”

Konstatimi i parë (I): “Eksperti shqyrtues sqaron se sa i përket arsytimit të eliminimit në piken e parë AK, në pozicionin 2 të Kërkesave të Kapacitetit Teknik dhe Profesional ka kërkuar serviser me certifikatë trajnimit për pajisje biokimike dhe hematologjike. OE ankues në oferte ka prezantuar Certifikatën me emër të z.Adna Bala, ku në të njëjtën përshkruhet se i njëjti ka përfunduar kursin online dhe është i certifikuar dhe trajnuar për mirëmbajtjen e pajisjeve të shërbimeve dhe riparimin e pajisjeve diagnostike vitro (IVD). In Vitro Diagnostics (IVD) ka të bëjë me analiza dhe pajisje laboratorike por nuk ka të bëjë me pajisjen biokimike dhe hematologjike ashtu siç është kërkuar në FDT, rrjedhimisht, eksperti shqyrtues vlerëson se AK - KK Rahovec, bazuar në nenin 59 të LPP-se i ka vlerësuar ofertat.”

Konstatimi i dytë (II) : “Pretendimi ankimor tjetër lidhur me arsytimin e dytë të eliminimit të ekspertit shqyrtues sqaron se AK - KK Rahovec, me datën 16.04.2024, përmes letrës standarde, kërkesë për sqarimin e tenderit nga OE ankues ka kërkuar sqarimin si më poshtë: “Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën, Serviser të Certifikuar për Adnan Bala, Kontrata e punës e prezantuar, tek pjesa për punëdhënësin, kontrata është e nënshkruar nga Nexhmije Bala, e cila nuk është bashkëpronarë në Certifikatën e Biznesit, po ashtu nuk ka ndonjë autorizim për nënshkrimin e kontratës; Në si Autoritet Kontraktues: Komuna e Rahovecit, kërkojmë nga ana juaj të na dorëzoni Autorizim të Kompanisë nga Noteri për Nexhmije Bala, që ka Autorizim për nënshkrimin e Kontratës, duke u bazuar në nenin 72”. OE ankues me datën 17.04.2024, ka ofruar sqarimet lidhur me të njëjtën kërkesë, por Autorizimi i prezantuar i datës 13.02.2023, është trajtuar si i pa pranueshëm nga AK pasi që i njëjti nuk është i noterizuar, por përmban vulën dhe nënshkrimin të kompanisë. Eksperti shqyrtues vlerëson se AK KK-Rahovec, vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave e ka realizuar duke u bazuar në depozitat ligjore të LPP-se, rrjedhimisht ka anuluar aktivitetin e prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Pro Medical Sh.P.K.” duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal – Rahovec në lidhur me aktivitetin e prokurimit

me “Servisimi i Pajisjeve Mjekësore” me nr. të prokurimit: “623-24-1132-2-2-1”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: